



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE VLORE

NOTER ORNELA H. DANI
ADRESA ÇLIRIMI, QEMAL STAFI,
NR.4/166, KATI PERDHE
TEL: 682068980

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 2242

Nr. koleksioni: 1663

Lushnje më 09/09/2025

Ornela
Dani

Firmosur elektronikisht nga
NISA me certifikaten
:Ornela Dani
Data: 2025.09.09
18:27:33+02:00


Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2025062110168050202

pull detyre
noter



KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(TË SHOQËRISË “3X ENËRGY” SH.P.K)

Sot, më datë **09/09/2025** , para meje Notere ORNELA H. DANI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën Lushnje, ÇLIRIMI, QEMAL STAFI, NR.4/166, KATI PERDHE, u paraqit personalisht:

SHITES:Agim Xhindoli, atësia Xhevdet, amësia Fahire, shtetas Shqiptar, lindur në Lushnje, Lushnjë dhe banues në LUSHNJE, me adresë Vath Korreshi 01710235; Nd. 74; H. 1; Lushnjë; Lushnjë; 9001; Lushnje, lindur më 07/06/1960, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033367429 dhe nr. personal G00607066L, .

BLERES:Adrian Dule, atësia Hektor, amësia Natasha, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë A. Visha P.13 Shk 2 Ap 26; Njësia Administrative Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 11/05/1966, gjendja civile “i divorcuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034128571 dhe nr. personal G60511130L, .

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “3X ENERGY” Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Meqënëse:

- a) Shitësi Z.Agim Xhindoli zotëron një kuotë të barabartë me 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë “3X ENERGY” SH.P.K, subjekt juridik i së drejtës shqiptare, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 03.02.2025 dhe identifikuar me NUIS M53804401H, synon të shesë 10% te kuotës që disponon në favor të Blerësit.
- b) Blerësi Z.Adrian Dule , ka shprehur interesin të blejë kuota në pronësi të Shitësit e barazvlefshme me 10 % (dhjete përqind) te kapitalit themeltar te shoqërisë “3X ENERGY” SH.P.K .
- c) Palët pranojnë të lidhin këtë Kontratë Shitblerje Kuotash (këtu e në vijim referuar si “Kontrata”), sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1

Kushtet paraprake

- 1.1. Kushtet paraprake të mësipërme përbëjnë pjesë thelbësore dhe qëllimin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

Neni 2

Shitja e kuotës

- 2.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi shet dhe transferon pjesën te kuotave të zotëruar prej tij në kapitalin e Shoqërisë, të barazvlefshme me 10 % (dhjete përqind) të kapitalit themeltar të



A2025062110168050202

Shoqërisë (këtu e në vijim referuar si "Kuota 1"), të lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, në favor të Blerësit i cili e pranon dhe e blen atë.

- 2.2. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi në përputhje dhe në proporcion me Kuotën e blerë, merr përsiër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e saj, sipas kushteve të rëna dakord dhe në veçanti të drejtën për të marrë pjesë në fitimet e Shoqërisë duke filluar nga viti ushtrimor dhe në vazhdim, për të ndarë pasurinë e Shoqërisë si dhe merr përsipër detyrimet dhe pasivet e mundshme.
- 2.3. Me transferimin e kësaj pjese të përqindjes pjesëmarrëse sipas kësaj Kontrate, kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë i përbërë nga 2 (dy) kuota, te cilat do të jete ne pronësi si më poshtë:

- **Agim Xhindoli**, atësia Xhevdet, amësia Fahire, shtetas Shqiptar, lindur në Lushnjë, Lushnjë dhe banues në LUSHNJE, me adresë Vath Korreshi 01710235; Nd. 74; H. 1; Lushnjë; Lushnjë; 9001; Lushnje, lindur më 07/06/1960, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033367429 dhe nr. personal G00607066L, zotërues i 90 % (nentedhjete përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë nominale 90.000 (nentedhjete mijë) Leke, e barazvlefshme me 1 (një) kuotë të kapitalit të regjistruar.
- **Adrian Dule**, atësia Hektor, amësia Natasha, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë A. Visha P.13 Shk 2 Ap 26; Njësia Administrative Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 11/05/1966, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034128571 dhe nr. personal G60511130L, zoterues i 10 % (dhjete perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise, me vlere nominale 10. 000 (dhjete mije) Leke , e barazvlefshme me 1 (nje) kuote te kapitalit te regjistruar

Neni 3

Çmimi

- 3.1. Çmimi i Shitjes për blerjen e përqindjes pjesëmarrëse në Shoqëri nga Blerësi për Shitësin do të jetë në vlerë të barabartë me 10 000 (dhjete mijë) Leke (këtu e në vijim referuar si "Çmimi i Shitjes"), çmimi i cili do të paguhet nga Blerësi sot ne date 09 Shtator 2025 .
- 3.2. Të gjitha pagesat dhe detyrimet e mundshme sipas kësaj Kontrate do të jenë në Lek.

Neni 4

Transferimi i Kuotës

- 4.1. Titulli i Kuotës do t'i transferohet Blerësit dhe Kuota do të shitet dhe do të blihet së bashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i zbatohen Kuotës ose që rrjedhin nga ajo në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 4.2. Palët do të nënshkruajnë dhe do të sigurojnë të gjitha dokumentet e nevojshme për regjistrimin e rregullt të transferimit të kuotës në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 5



A2025062110168050202

- 5.1. Shitësi garanton Blerësin se është personi i vetëm legjitim për të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate.
- 5.2. Shitësi garanton Blerësin se Kuota, objekt i kësaj Kontrate, është e lire nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo e drejtë tjetër në favor të të tretëve.
- 5.3. Në momentin që nënshkruhet kjo Kontratë, pala shitëse deklaron se nuk ka asnjë pretendim pronësie për kuotën që shet dhe asnjë formë tjetër të mundshme pretendimi nga ana e vetë Shoqërisë.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 6.1. Të gjitha mosmarrëveshjet midis Palëve që mund të lindin ose që lidhen me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e kësaj Kontrate, do të zgjidhen në përgjithësi me mirëkuptim midis Palëve.
- 6.2. Nëse nuk arrihet që një mosmarrëveshje të zgjidhet me mirëkuptim, palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Neni 7

Ligji i Zbatueshëm

- 7.1. Kjo Kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar dhe interpretimi i saj do të bëhet në përputhje me aktet ligjore në fuqi në momentin e nënshkrimit të Kontratës.

Neni 8

Përmbajtja e Kontratës dhe Ndryshimet

- 8.1. Kjo Kontratë përfshin tërësisht raportet ndërmjet Palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme në lidhje me objektin në fjalë. Ndryshimet apo shfuqizime të ndryshme të kësaj Kontrate mund të bëhen vetëm me shkrim dhe do të nënshkruhen nga Palët.

Neni 9

Konfidencialiteti

- 9.1. Asnjëra prej Palëve nuk duhet të zbulojë pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër tek ndonjë person, apo të bëjë një njoftim publik në lidhje me informacionet që prekin dispozitat e kësaj Kontrate dhe/ose transaksioneve objekt i saj.
- 9.2. Kur njëra prej Palëve vendos në mënyrë të arsyeshme se zbulimi ose njoftimi i informacionit të përmendur më sipër kërkohet në bazë të ligjit, rregulloreve ose çdo autoriteti tjetër të cilit njëra Palë i nënshtrohet, ky zbulim ose njoftim i informacionit, për aq sa ligji lejon, nëse është e mundur në mënyrë të arsyeshme, do të kryhet pas konsultimit me Palën tjetër.

BAZA LIGJORE

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij; Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"; Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

ANEKSET E KONTRATËS

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneke të Kontratës;



A2025062110168030202

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve me nr. 2, datë 08/09/2025, bashkëlidhur vërtetim nënshkrimi nr. rep, Notere Ornela Dani;
- Ekstrakt i Regjistrit Tregtar për Shoqërinë "3X ENERGY" Sh.p.k.. datë 09/09/2025;
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITES



BLERES

Notere
ORNELA H. DANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E
SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"**

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M53804401H
2. Data e Regjistrimit	04/02/2025
3. Emri i Subjektit	3X ENERGY
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	03/02/2025
6. Kohëzgjatja	Nga: 03/02/2025
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Fier Lushnje Lagjja Gafurr Muço, Zona industriale, Nr. 1, Pasuria me Nr. 13/131
8. Kapitali	100.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	Prodhim i energjise elektrike nga impiante gjeneruese fotovoltaike, eolike, hidrike, etj, si dhe tregtim i energjise elektrike. Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) te energjise elektrike, te cilat shfrytezojne burimet e rinovueshme te energjise si dielli, era, uji, si dhe i veprave te tyre ndihmese. Aplikimi dhe marrja nga qeveria shqiptare apo institucionet pergjegjese te shtetit shqiptar i te gjitha lejeve, licencave dhe autorizimeve paraprake/perfundimtare, te cilat mundesojn zhvillimin e ketyre aktiviteve ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Shitja me shumice dhe pakice e energjise elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energjis elektrike (vendas apo te huaj), si dhe ne Bursen Shqiptare te Energjise Elektrike, apo Bursat e tjera jashtë vendit. Gjithashtu, per te realizuar objektivat e saj, shoqeria mund të ndermarre te zhvilloje edhe cdo lloj aktiviteti tjetër te ligjshëm ne territorin e Republikes se Shqiperis dhe qe siguron te ardhura dhe fitime te ligjshme. Ndertime civile,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	ekonomike, germime dheu, sistemim tarracime, prodhime 2 elementesh të parafabrikuara, betoni, e beton arme dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to. Ndërtim të rrugëve kategorive të ndryshme, veshje me asfaltobeton të rrugëve/ndërtim mbishtës, sistemim dhe asfaltim sheshi e punime karpeterie, rikonstruksione godina civile, industriale etj. Punime hidraulike, punime /shtrim linja elektrike 2 etj. Kultivim import-export i prodhimeve bujqësore.	
10. Administratori/ët	Agim Xhindoli	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 03/02/2025	Deri: 03/02/2030
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Agim Xhindoli	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: 3X ENERGY E-Mail: info@pmg.al Telefon: 0692722579	
15. Statusi:	Aktiv	

Datë: 09/09/2025

Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date: 2025/09/09 18:28:25 +02:00
m53804401h2025090918281661
2006

